

# **RAPORT MBI ECURINË E VEPRIMTARISË SË KORPORATËS SË INVESTIMEVE SHQIPTARE (AIC)**

Korrik 2022

Në Korrik 2021, filloi operacionalizimi i Korporatës së Investimeve Shqiptare Sh.A. (në vijim referuar si "AIC".) AIC operon në tregun Shqiptar si një shoqëri aksionere me aksioner të vetëm Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, me opsionin që edhe institucione ndërkombëtare financiare mund të bëhen aksionere në të.

AIC synon të kontribuojë në rritjen ekonomike në vend nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve ekonomike, akumulimit të know-how dhe ngritjes së kapaciteteve. AIC investon në zhvillimin e projekteve fizibël nga ana komerciale, si dhe me impakt në ekonominë e vendit.

Gjatë vitit të parë, fokusi i punës ka qënë në: 1) ndërtimin e ekipit bazë dhe kapaciteteve të brendshme korporative, 2) zhvillimin e një project-pipeline, si dhe 3) sigurimin e rritjes së nevojshme të kapitalit për financimin e aktiviteteve investuese.

Në përfundim të vitit të parë, AIC ka ndërtuar një ekip koheziv ekspertësh me kohë të plotë dhe të pjesshme, si dhe ka një Bord Mbikëqyrës me anëtarë nga institucionet qendrore dhe të pavarur. AIC ka krijuar raporte me partnerë institucionalë për të identifikuar asete dhe projekte të mundshme, organizata multilaterale, dhe organizata simotra në vende të tjera. Në këtë drejtim, ekipi i AIC ka shqyrtuar dhjetëra asete dhe projekte potenciale investimi në fushat e industrisë dhe logjistikës, turizmit, energjisë dhe bujqësisë, me qëllim identifikimin e atyre që ushqejnë potencialin më transformues nga këndvështrimi i qëndrueshmërisë tregtare dhe ndikimi në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, i matur nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve ekonomike, dhe akumulimit të know-how për të ndërtuar kapacitete të reja në vend.

## **I. RAPORT I ECURISË SË VEPRIMTARISË SË AIC**

### **1. Rreziqet e biznesit**

AIC për vitin 2021, nuk ka patur ndonjë rrezik të likuiditetit. Në përgjithësi rreziku i likuiditetit është rreziku që kompania mund të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve financiare të saj, të cilat shlyhen me anë të mjeteve monetare apo të ndonjë aktiviteti tjetër financiar. Qëllimi i AIC në administrimin e likuiditetit është që të sigurojë se do të ketë likuiditetin e mjaftueshëm për përmbushjen e detyrimeve në kohë, si në kushtet normale ashtu edhe në vështirësi, pa patur humbje të papranueshme apo pa rrezikuar dëmtimin e reputacionit.

Në fund të vitit 2021, AIC nuk ka detyrime financiare materiale apo afatgjatë.

AIC është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit lidhur me ndryshimet e mundshme në normat e kurseve të këmbimit për sa i përket transaksioneve të saj në monedhë të huaj. Sidoqoftë, këto transaksione nuk janë materiale gjatë periudhës raportuese 2021.

AIC nuk përballlet me ndonjë rrezik të rëndësishëm të normave të interesit të flukseve monetare, sepse ajo nuk disponon detyrime financiare të cilat gjenerojnë interesa.

Për sa më sipër, vlerësimet janë sipas Pasqyrave Financiare të miratuara për vitin 2021.

## **2. Aksionet**

Kapitali aksionar i autorizuar dhe i regjistruar i AIC është 2,198,000,000 Lekë (2020: 198,000,000 Lekë), i cili është në pronësi të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Gjatë vitit 2021 nuk ka pasur ndryshime në strukturën e kapitalit të AIC, por ka pasur rritje në vlerën e kontributit aksionar, me shumën 2,000,000,000 Lekë.

## **3. Selia dhe Degët**

AIC zhvillon aktivitetin në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Tiranë.

## **4. Politikat dhe objektivat e administrimit të riskut financiar, ekspozimi i AIC ndaj risqeve financiare & sasive të riskut**

Politikat dhe objektivat për administrimin e rreziqeve financiare, si dhe sasitë përkatëse, përfshihen në shënimet e Pasqyrave Financiare.

## **5. Objektivat e AIC për vitin 2022**

- Konsolidimi i suksesit dhe ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve të brendshme.
- Plotësimi i mëtejshëm i qeverisjes korporative, politikave dhe rregullave të brendshme të funksionimit dhe organizimit.
- Identifikimi i projekteve të investimit.
- Zgjerimi i marrëdhënieve me partnerët dhe ndërtimi i aleancave të bashkëpunimit.

## II. RAPORTI I DREJTIMIT TE BRENDSHËM

### 1. Qeverisja e AIC

Në bazë të Nenit 11, të Ligjit Nr. 71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, organet qeverisëse të AIC janë:

1. Asambleja e Përgjithshme.
2. Këshilli Mbikëqyrës.
3. Drejtori Ekzekutiv.
4. Bordi Këshillimor.

**Asambleja e Përgjithshme** përbëhet aktualisht nga një aksioner i vetëm – i.e., Ministria e Financave dhe Ekonomisë, së Republikës së Shqipërisë, me adresë të regjistruar: “Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë, Shqipëri.

Gjatë vitit 2021, anëtarët e **Këshillit Mbikëqyrës** dhe afatet përkatëse të emërimit kanë qënë si vijon:

#### Emër/Mbiemër

#### Afati i Emërimit

Adelina Xhemali

15/07/2020-15/07/2023

Ellis Juan

15/07/2020-15/07/2023

David Kennedy

15/07/2020-15/07/2023

Majlinda Dhuka

15/07/2020-15/07/2023

**Drejtori Ekzekutiv** është Dr. Ermal Frashëri.

**Bordi Këshillimor**, pjesë e organeve qeverisëse të AIC, nuk është formuar gjatë periudhës raportuese 2021.

### III. RAPORTIMI I PAGESAVE QË U BËHEN INSTITUCIONEVE SHTETËRORE

Raporti i mëposhtëm është përgatitur në përputhje me nenin 21, të Ligjit për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare Nr. 25/2018, datë 10.05.2018.

Tabela e mëposhtme tregon pagesat e kryera tek autoritetet tatimore shtetërore, sipas llojit të treguar të taksave ose kategorive.

	Shuma
Kontributet e Sigurimeve Shoqërore	ALL 579,945
Kontributet e Sigurimeve Shëndetësore	ALL 180,745
Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi (TAP)	ALL 878,960
<b>Total Kontribute dhe TAP (1)</b>	<b>ALL 1,639,650</b>
<b>Tatim ne burim (2)</b>	<b>ALL 1,162,131</b>
<b>Total paguar taksa për tatim taksat (1)+(2)</b>	<b>ALL 2,801,781</b>

\*\* Shumat e mësipërme paraqesin pagesat aktuale të bëra nga AIC gjatë vitit kalendarik dhe detyrimet deri me 31 Dhjetor 2021.

  
Dr. Ermal Frashëri  
Drejtor Ekzekutiv

